



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.4.2023

Nr: 364

Ora: 10:30

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË TELEVIZIONEVE “REPORT TV” DHE “NEWS 24”

PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot në datën 15.4.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

- KËRKUES:** Televizioni “Report TV”, Rruga “Ndre Mjeda”, Tiranë, me përfaqësues znj. Vilma Theodhosi
Televizioni “News 24”, Ish - Uzina e Autotraktorëve në Tiranë, me përfaqësues z. Robert Rakiplari
- OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të medias për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.1.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”

V Ë R E J:

Televizioni “Report TV” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 64 (gjashtëdhjetë e katër) gazetarë, si dhe zonat e vëzhgimit të

Data: 15.4.2023 Nr: 364
Ora: 10:30



“Për shqyrtimin e kërkesave të televizioneve “Report TV” dhe “News 24” për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni "Report TV" është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni "News 24" i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 51 (pesëdhjetë e një) gazetarë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni "News 24" është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.1.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave",

V E N D O S:

1. Akreditimin e gazetarëve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, të 64 (gjashtëdhjetë e katër) gazetarëve të televizionit "Report TV", sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e gazetarëve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, të 51 (pesëdhjetë e një) gazetarëve të televizionit "News 24", sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI